



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primjenat/Prodato Received/Delivery | 03.04.2023 | 3 viti god yngj | |
| Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKOMBICK | 3277/2023 | | 115 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.304/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.304/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër organit të punësimit/ Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike *'kërkesë nga marrëdhënia e punës'*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.304/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Port: 24 i datës 10.01.2023 i Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datën 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1246/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 09.01.2023 të organit të punësimit/ Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 28.11.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Administrata Tatimore të Kosovës. Ndërsa Këshilli,

me datën 03.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1246/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 28.11.2022; Raport mjekësor i datës 30.11.2022; Raport mjekësor i datës 15.11.2022; Letërnjoftimi i ankuesit; Email i datës 02.02.2023 me raportet e mjekut të ankuesit; Email i datës 03.02.2023 të ankuesit për këshillin si prova shtesë; Email i datës 03.01.2023 drejtuar sektorit të burimeve njerëzore; Email i datës 04.01.2023 nga sektori i burimeve njerëzore; Email i datës 19.01.2023 drejtuar sektorit të burimeve njerëzore; Email i datës 23.01.2023 nga sektori i burimeve njerëzore; Email i datës 27.01.2023 drejtuar sektorit të burimeve njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1833/2023 të datës 15.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 2338/2023 të datës 03.03.2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës; Akt emërimin e ankuesit me numër AE.Nr.393/2022 të datës 31.12.2022; Vendimi për Transferim me nr.393/2022 i datës 22.12.2022; Formulari mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Akt emërimin e ankuesit me numër Prot.02/868/09 të datës 24.12.2012; Formulari mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Përshkrimi i Punës; Formulari mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Email i datës 08.11.2023 drejtuar organit të punësimit; Email i datës 05.12.2023 nga ankuesi dhe organi i punësimit; Email i datës 10.01.2023 nga organi i punësimit; Vendimit të datës 09.01.2023 të organit të punësimit mbi refuzimin e kërkesës së ankuesit për pushim të veçantë pa pagës; Raport mjekësor i datës 30.11.2022; Shkresë e datës 15.11.2022; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 19.05.2022; Raport mjekësor i datës 17.05.2022; Vendimit të datës 31.05.2022 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Email i datës 30.05.2022 nga organi i punësimit; Vendimit të datës 31.12.2021 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Email i datës 07.12.2021 drejtuar organit të punësimit; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 03.12.2021; Raport mjekësor i datës 03.12.2021; Vendimit të datës 16.08.2021 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Email i datës 13.08.2021 nga organi i punësimit; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 09.08.2021; Udhëzim për konsultim me nr.0013047; Raport nga konsulta; Raport i Qendrës Spitalore; Udhëzim për konsultim me nr.004609; Raport nga konsulta; Raport Specialistik "SYRI" i datës 27.07.2021; Raport mjekësor i datës 25.06.2021; Shkresë e datës 18.06.2021; Raport nga konsulta ¼; Udhëzim për konsultim ½; Raport nga konsulta ½; Spitali Regjional Mitrovicë; Udhëzim për konsultim me nr.006258; Raport nga konsulta ½; Raport specialistik i datës 26.12.2015; Qendra Klinike Universitare - Prishtinë; Fletudhëzim i datës 22.03.2004; Raport mjekësor i datës 17.12.2019; Raport mjekësor i datës 29.11.2019; Raport mjekësor i datës 13.12.2019; Raport mjekësor i datës 05.11.2019; Vendimit të datës 29.12.2020 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Email i datës 08.12.2020 drejtuar organit të punësimit; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 07.12.2020; Raport mjekësor i datës 04.12.2020; Email i datës 08.12.2020 nga organi i punësimit; Vendimit të datës 27.12.2019 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 08.01.2019; Email i datës 08.01.2019 nga organi i punësimit; Raport nga konsulta ½ e datës 03.01.2019; Raport mjekësor i datës 09.03.2018; Raport nga konsulta e datës 09.02.2018; Raport nga konsulta e datës 20.11.2017; Raport nga konsulta e datës 24.11.2017; Raport nga konsulta e datës 20.10.2016; Raport nga konsulta e datës 24.11.2015; Udhëzim për hulumtime diagnostike e datës 30.12.2015; Udhëzim për hulumtime

diagnostike e datës 24.11.2015; Raport nga konsulta e datës 16.12.2015; Raport nga konsulta e datës 23.12.2015; Raport nga konsulta e datës 21.10.2016; Fletëlëshim i datës 25.04.2016; Raport nga konsulta e datës 30.11.2015; Raporti i laboratorit i datës 21.11.2015; Spitali rajonal Mitrovice e datës 23.11.2015; Udhëzim për laborator i datës 12.11.2010; Raporti i laboratorit i datës 04.11.2017; Raporti i laboratorit i datës 21.11.2015; Raporti i laboratorit i datës 21.12.2015; Raporti i laboratorit i datës 24.12.2015; Raporti i laboratorit i datës 10.09.2016; Analiza parazitologjike e datës 02.12.2015; Raport mjekësor i datës 24.11.2015; Udhëzim për konsultim nr.006258; Raporti i laboratorit i datës 06.05.2016 ½; Raport nga konsulta e datës 21.01.2016; Raport mjekësor i datës 14.12.2015; Raport mjekësor i datës 16.12.2015; Raporti i laboratorit i datës 02.07.2016 1/3; Raporti i laboratorit i datës 20.02.2016 ½; Raport laboratorik i datës 30.05.2016; Raport laboratorik i datës 23.12.2015; Analiza mikrobiologjike me nr.6873; Analiza mikrobiologjike me nr.6937; Analiza mikrobiologjike me nr.6948; Recetë për barna nr.3482566 ½; Kërkesës e ankuesit për pushim të veçantë pa pagës e datës 10.12.2019; Raport mjekësor i datës 16.12.2019; Raport mjekësor i datës 17.12.2019; Raport mjekësor i datës 13.12.2019; Raport mjekësor i datës 29.11.2019; Raport mjekësor i datës 05.11.2019; Raport mjekësor i datës 14.10.2019; Raport mjekësor i datës 05.11.2019; Raport mjekësor i datës 16.10.2019; Raport mjekësor i datës 15.11.2019; Raport mjekësor i datës 15.10.2019; Raport mjekësor i datës 14.10.2019; Raport mjekësor i datës 22.11.2019; Raport mjekësor i datës 13.11.2019; Raport mjekësor i datës 15.10.2019; Raport mjekësor i datës 06.03.2020; Fletëlëshim me nr.1230; Udhëzim për te mjeku specialist i datës 22.03.2004; Raport nga konsulta e datës 03.01.2019 1/3; Vendimit të datës 27.10.2016 të organit të punësimit mbi lejimin e pushim pa pagës; Kërkesë e datës 25.10.2016; Prova shtesë të datës 20.03.2023 nga organi i punësimit sipas kërkesës se KPMSHCK me email të datës 17.03.2023; Listën e vijueshmërisë në punë, mars 2023; Listën e vijueshmërisë në punë, janar 2023; Listën e vijueshmërisë në punë, shkurt 2023; Email për dëshminë e pranimit të vendimit nga ankuesi të datës 10.01.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 31.12.2022, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Inspektor i mesëm tatimor", në Administratën Tatimore të Kosovës. I njëjti me datë 28.11.2022 përmes mbikëqyrësit të tij gjegjësisht Udhëheqësit të ekipit ka parashtruar kërkesë te Njësia e Burimeve Njerëzore, për aprovim të pushimit të veçantë pa pagesë, për arsye të vazhdimit të trajtimit shëndetësor jashtë vendit, në kohëzgjatje për 1 (një) viti duke filluar nga data 01.01.2023 deri me 31.12.2023.

Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës përmes vendimit me numër protokollit nr.24 të datës 09.01.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 28.11.2022 si të pabazuar, me arsyetimin se ka shfrytëzuar pushim pa pagesë nga data 01.02.2019 deri më datë 31.12.2022 dhe nuk ka ofruar dëshmi bindëse e as rekomandim nga organi kompetent mjekësor se duhet ti vazhdohet pushimi pa pagës edhe me tutje.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se pushimi i veçantë pa pagesë i takon në bazë të nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Me tej shton se kërkesa bazohet në trajtim shëndetësor jashtë vendit për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, kështu që propozon që Këshilli ta aprovoj anekses si të bazuar dhe të aprovoj pushimin pa pagës.

Kolegji i Këshillit, në bazë të shqyrtimit të provave materiale të lëndës, konstaton se fillimisht ankuesit sipas Vendimit me Nr. Prot: 538 të datës 27.10.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi mjekësor pa pagesë për periudhën nga data 01.12.2016 deri më datë 31.05.2017, sipas Vendimit me Nr. Prot: 1107 të datës 27.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi pa pagesë prej datës 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020, sipas Vendimit me Nr. Prot: 253 të datës 29.12.2020 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi pa pagesë prej datës 01.01.2021 deri më datë 30.06.2021, Vendimit me Nr. Prot: 256 të datës 19.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi pa pagesë prej datës 01.09.2021 deri më datë 31.12.2021, sipas Vendimit me Nr. Prot: 01 të datës 31.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi pa pagesë prej datës 01.01.2022 deri më datë 30.06.2022 dhe sipas Vendimit me Nr. Prot: 285 të datës 31.05.2022 të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës i është lejuar pushimi pa pagesë prej datës 01.07.2022 deri më datë 31.12.2022.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 18 paragrafi 4, i cili përcakton se: *"Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës"*, ndërlidhur me këtë e drejta e pushimit të nëpunësve civil është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë. Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës me të cilin është theksuar se: *"1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit"*, ndërsa Rregullorja Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht neni 16 ka përcaktuar se: *"1. Në bazë të kërkesës të zyrtarit publik, udhëheqësi më i lartë administrativ mund të lejojë që zyrtarit publik të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. 3. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendim marrje tek udhëheqësi më i lartë administrativ. Përgjashtimisht, ky afat nuk aplikohet në rast të pushimit mjekësor pa pagesë. 4. Vendimi i dorëzohet pa vonesë zyrtarit dhe Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. 5. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1 i këtij neni, zyrtarit publik i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës"*, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunësit civil kanë të drejtë të realizimit të pushimit pa pagesë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe trajtimit të nevojshëm shëndetësor, mirëpo ankuesi pushimin pa pagesë për shkak të gjendjes shëndetësore e ka shfrytëzuar për një kohë të gjatë mbi tre (3) vite dhe dokumentet e dorëzuara nuk janë dokumente bindëse përmes të cilave do të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e ankuesit.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më konkretisht me nenin 53 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, është përcaktuar se: *"1. Transferimi i përhershëm është caktimi*

i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës”, kështu që në rastet kur nëpunësi civil nuk mund të ushtroj pozitën përkatëse për shkak të gjendjes shëndetësore, atëherë i njëjti mund të kërkoj transferimin në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori ku është i aftë të kryejë detyrat, siç parashihet me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. Port: 24 i datës 10.01.2023 i zëvendësuesit i Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës, është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj bazuar ne dispozitat e legjislacionit në fuqi ankuesit nuk i takon pushimi pa pagës për periudhën (1) vjeçare sepse bje ndesh me ligjet të cilat e rregullojnë këtë çështje, edhe pse ankuesi ka shfrytëzuar pushimin pa pagës nga data 01.02.2019 deri me date 31.12.2022.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.304/2023.

Vjollca SINANI



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së